



TRANSFORMATIONAL LEADERSHIP PROGRAM – SCHOLARSHIPS AND PARTNERSHIPS

Njoftim për aplikim në Kursin:

”Përgatitja e kafshës para anestezisë, intubimi endotrakeal, aplikimi i anestezisë inhalatore në qen dhe mace, dhe protokole të ndryshme anestetike”, 16 shkurt, 2017

Stafi i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë - Universiteti i Prishtinës dhe Kolegji i Mjekësisë Veterinare nga Universiteti i Minesotës-SHBA do të ofroj një Kurs një ditor mbi përgatitjen e kafshës para anestezisë, intubimin endotrakeal, aplikimin e anestezisë inhalatore në qen dhe mace, si dhe protokole të ndryshme anestetike, ditën e Enjte me datën 16.02.2017, nga ora 10.

Ky kurs do të filloj me njoftimin mbi kursin dhe përmban diskutime të hapura të temave të zgjedhura. Në kuadër të kursit 1 ditor janë të paraparë përgatitjet e kafshës para anestezisë, intubimi endotrakeal, aplikimi i anestezisë inhalatore në qen dhe mace, dhe aplikimi i protokoleve të ndryshme anestetike.

INSTRUKTORËT: Në mësimdhënie do të jetë i kyçur Profesori i Kirurgjisë nga departamenti i Mjekësisë Veterinare nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë-Universiteti i Prishtinës dhe Prof. Dr. Sandra Allweiler, Diplomate DVM, Diplomate DACVA nga Kolegji i Mjekësisë Veterinare nga Universiteti i Minesotës-SHBA si pjesë e programit: Projekti i lidërsipit transformues (Transformational Leadership Project) Bursa & partneritete.

LOGJISTIKA: Kursi do të zhvillohet për një periudhë një ditore në klinikën e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë. Pas aplikimit të metodave të reja në fushën e Anesteziologjisë, studentët do të kryejnë dhënjën e injeksioneve pre anestetike, anestetikëve, futjen e tubit endotrakeal si dhe aplikimin e anestezisë inhalatore.



PJESËMARRËSIT: Në kurs do të kyçen një numër prej gjashtë studentëve nga departamenti i Mjekësisë Veterinare (viti i katërt dhe i pestë).

Numri maksimal i pjesëmarrësve do të jetë 6 student. Kursi do të zhvillohet në gjuhën angleze. Luteni që të plotësoni aplikacionin e regjistrimit që mund të shkarkohet ose të merret në Institutin e Blegtorisë dhe Veterinarisë (Znj. Vera Godeni) çdo ditë nga ora 8:30 deri në orën 14:00, deri në ditën e fundit të aplikimit më 15 Shkurt 2017 dhe të dorëzohet në të njëjtën zyrë.

**Aplikacioni për kursin ”Përgatitja e kafshës para
anestezisë, intubimi endotrakeal, aplikimi i
anestezisë inhalatore në qen dhe mace, dhe
protokole të ndryshme anestetike”**

Njoftim: Plotësoni këtë aplikim duke bashkëlidhur një rezymë dhe dorëzoni në Institutin e Blegtorisë dhe Veterinarisë ose në email adresën: bekim.selimi@uni-pr.edu

Emri dhe Mbiemri:

Telefoni:

Programi studimor në UP:

Viti

studimeve:

E-mail

adresa:

Shkruani njohuritë tuaja në gjuhë angleze dhe notën mestare.

Shfrytëzoni këtë hapësirë që të shkruani arsyet tuaja për pjesëmarrje në këtë kurs dhe se çka dhe si do të përfitoni nga ky kurs:

Nënshkrimi:

Unë pajtohem me kushtet e sipërpërmendura dhe dëshiroj që të konsiderohem për pjesëmarrje në kursin: "Përgatitja e kafshës para anestezisë, intubimi endotrakeal, aplikimi i anestezisë inhalatore në qen dhe mace, dhe protokole të ndryshme anestetike", **me datën 16.02.2017**

Nënshkrimi:

Me datë: